

VENDIM
Nr. 279, datë 2.5.2019

PËR PËRBËRJEN, MËNYRËN E FUNKSIONIMIT, KOMPETENCAT DHE SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË MENAXHIMIT TË PASURIVE KULTURORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 37, të ligjit nr. 27/2018, “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITË E PËRGJITHSHME

Ky vendim ka për qëllim të rregullojë përbërjen, mënyrën e funksionimit, ushtrimin e kompetencave dhe shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore.

II. PËRBËRJJA E KËSHILLIT KOMBËTAR TË MENAXHIMIT TË PASURIVE KULTURORE

1. Këshilli Kombëtar i Menaxhimit të Pasurive Kulturore (në vijim KKMPK) është organi kolegjal vendimmarrës pranë ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

2. KKMPK-ja ka në përbërje 11 anëtarë, kryesohet nga ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe 10 anëtarë që emërohen prej tij.

3. KKMPK-ja përbëhet nga:

- a) ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore;
- b) 2 përfaqësues të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK);
- c) 2 përfaqësues nga ministria përgjegjëse për kulturën;
- ç) 1 përfaqësues nga Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore (IKRTK);
- d) 5 personalitete të cilët kanë një eksperiencë të pasur profesionale në fushën e jurispruencës, ekonomisë ose menaxhimit.

4. Anëtarët e KKMPK-së përmbushin detyrën dhe përgjegjësitë e tyre dhe deklarojnë çdo rast të konfliktit të mundshëm të interesit, në përputhje me ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

5. Mandati i anëtarit të KKMPK-së është 2 vjet, me të drejtë riemërimi. Anëtari qëndron në detyrë dhe përmbush funksionet deri në emërimin e anëtarit të ri.

6. Anëtar i KKMPK-së emërohet individ që:

- a) zotëron diplomë të nivelit “Master profesional” apo “Master shkencor” dhe eksperiencë 5-vjeçare në fushat e jurispruencës, menaxhimit ose ekonomisë;
- b) nuk është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprës penale.

7. Mandati i anëtarit të KKMPK-së mbaron kur:

- a) përfundon afati i emërimit;
- b) lirohet nga funksioni zyrtar, përveç personaliteteve;
- c) jep dorëheqjen;

8. Ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore liron nga detyra anëtarin, para mandatit, në rastet kur:

- a) nuk paraqitet pa shkak të justifikuar në 5 mbledhje të njëpasnjëshme të KKMPK-së;
- b) ka pengesë objektive për ushtrimin e funksioneve për më shumë se 6 muaj;
- c) nuk përmbush detyrimet si anëtar i KKMPK-së;
- ç) dënohet me vendim penal të formës së prerë;

d) kur veprimet apo mosveprimet e tij kanë dëmtuar rëndë veprimtarinë dhe emrin e KKMPK-së.

III. ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I KËSHILLIT KOMBËTAR TË MENAXHIMIT TË PASURIVE KULTURORE

1. KKMPK-ja mbledhet jo më pak se një herë në 2 muaj. Mbledhjet e KKMPK-së thirren nga kryetari dhe njoftimi përcillet nga sekretaria teknike, të paktën 3 (tre) ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen. Në raste të veçanta, mbledhja mbahet edhe në një ditë të ndryshme nga njoftimi kur janë të pranishëm të gjithë anëtarët dhe bien dakord për zhvillimin e mbledhjes në atë ditë dhe atë orë. Vendimi reflektohet në procesverbalin e mbledhjes.

2. Njoftimit për thirrjen e mbledhjes përmban vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës. Njoftimit i bashkëlidhen materiale të tjera lidhur me çështjet e rendit të ditës. Rendi i ditës miratohet nga kryetari.

3. Mbledhja e KKMPK-së mund të kërkohej edhe nga 1/3 e anëtarëve, duke i drejtuar kërkesë ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore. Zhvillimi i mbledhjes në këtë rast miratohet nga kryetari dhe i njoftohet të gjithë anëtarëve.

4. Mbledhjet e KKMPK-së zhvillohen, gjithmonë, në prani të kryetarit dhe janë të vlefshme kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Në rast të mosarritjes së kuorumit të kërkuar, kryetari thërret mbledhjen pasardhëse.

5. Anëtarët e KKMPK-së, të cilët janë të pranishëm në mbledhje, nuk mund të abstenojnë.

6. KKMPK-ja vendos me shumicën e thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm.

7. Vendimet e KKMPK-së merren me votim të hapur.

8. Kryetari i KKMPK-së voton i fundit. Në rastet kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.

9. Vendimet e KMPK-së nënshkruhen nga kryetari dhe siglohen nga sekretari i KKMPK-së.

IV. KOMPETENCAT E KËSHILLIT KOMBËTAR TË MENAXHIMIT TË PASURIVE KULTURORE

Kompetencat e Këshillit Kombëtar të Menaxhimit të Pasurive Kulturore janë, si më poshtë vijon:

a) miratimi i strategjisë për administrimin e qëndrueshëm ekonomik dhe format e bashkëpunimit në trashëgiminë kulturore;

b) miratimi i programit të zhvillimit në territor të trashëgimisë kulturore;

c) këshillimi i ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore për çështjet, si më poshtë vijon:

i. tipologjinë e aktiviteteve tregtare që zhvillohen në ambientet e pasurive kulturore dhe në zonat e mbrojtura, si dhe kërkesat e subjekteve të veçanta për ushtrimin e aktiviteteve tregtare në zona me pasuri kulturore;

ii. termat e referencës dhe planet për menaxhimin e pasurive kulturore të paluajtshme;

iii. revokimin e licencës së veprimtarisë tregtare të pasurive kulturore për subjekte të veçanta;

iv. hapjen e procedurës së konkurrimit për dhënien në rëjetëzim;

ç) miratimi i kriterëve për licencimin e subjekteve tregtare të dedikuara në fushën e promovimit e të prezantimit të vlerave kulturore, në ekspozita kombëtare e ndërkombëtare;

d) miratimi i kriterëve për dhënien e licencave për ekspert vlerësues të pasurive kulturore;

dh) miratimi i metodologjisë për vlerësimin, pikëzimin dhe dhënien e bonusit në procedurat publike të kalimit në administrim indirekt të pasurive kulturore;

e) hartimi, miratimi e propozimi të ministri i marrëveshjeve të partneritetit publik privat në lidhje me pasuritë kulturore;

ë) përcaktimi i kufijve minimalë dhe maksimalë të tarifave të përdorimit të pasurive kulturore në pronësi publike, me përjashtim të pasurive kulturore që janë në administrim të:

i. ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe institucioneve të saj të varësisë, të cilat rregullohen sipas pikës 4, të nenit 178, të ligjit nr. 27/2018;

ii. fondacioneve të posaçme të krijuara sipas nenit 172, të ligjit nr. 27/2018, të cilat rregullohen sipas pikës 5, të nenit 178, të ligjit nr. 27/2018; dhe

iii. organeve të pushtetit vendor, që rregullohen sipas ligjit dhe akteve nënligjore për vetëqeverisjen vendore.

f) Propozimi të ministri përgjegjës për trashëgiminë kulturore i tarifave të përdorimit të pasurive kulturore në administrim të ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore dhe muzetë dhe institucioneve të saj të varësisë;

g) Përcaktimi i mënyrës së përdorimit dhe i destinacionit të pasurive kulturore dhe shqyrtimi i kërkesave për ndryshimin e destinacionit të përdorimit të pasurive kulturore;

gj) Përcaktimi i kriterëve dhe i formatit të deklaratës së interesit kulturor ose shkencor të ekspozitave apo panairëve dhe të çdo iniciative tjetër me karakter kulturor, me qëllim zbatimin e lehtësirave të parashikuara nga normativat fiskale;

h) Shqyrtimi dhe dhënia e mendimeve ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore mbi projektet e propozuara nga institucionet e fushave përkatëse, që do të financohen nga fondet për trashëgiminë kulturore;

i) Vendosja e afateve, mënyrave, orareve, shpërblimit dhe të drejtave e detyrimeve të pronarit ose të poseduesit për hapjen për publikun të pasurive kulturore, të cilat i janë nënshtruar ndërhyrjeve ruajtëse dhe që nuk përdoren për banim nga pronari ose poseduesi, në rast të mosarritjes së marrëveshjes ndërmjet pronarit ose poseduesit të pasurisë kulturore dhe ministrisë përgjegjëse për kulturën;

j) Përcaktimi i niveleve minimale të unifikuara të cilësisë së veprimtarisë së vlerësimit të pasurive kulturore në pronësi publike;

k) Vendosja e dhënies në administrim të pasurive kulturore personave fizikë ose juridikë publike ose privatë, sipas procedurave publike të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave;

l) Çdo kompetencë tjetër të parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fushën e trashëgimisë kulturore dhe muzeve.

V. SHPËRBLIMI

Shpërblimi për pjesëmarrje në mbledhje, për çdo anëtar, bëhet sipas përcaktimeve të bëra në vendimin normativ të masës së shpërblimit të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore.

VI. DISPOZITË E FUNDIT

Ngarkohen Ministria e Kulturës, Këshilli Kombëtar i Menaxhimit të Pasurive Kulturore dhe institucionet e tjera në fushën e trashëgimisë kulturore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama